

të tyre, i cili do të përbëhet nga 5 anëtarë, përfshirë edhe shoqërinë civile dhe grupet tjera të interesit. Ai ka thënë se 2 anëtarë të këtij komisioni, sipas rregullores, duhet të jenë nga dy partitë më të mëdha në komunë, në këtë rast PDK e SLS, një nga shoqëria civile, një nga ekzekutivi komunal dhe i pesti

Reshmitari opozitar, Ali Halimi, ka kërkuar menjëherë të përzgjedhjes së anëtarëve të komisionit kryetarëve të fshatrave, ngase, sipas tij, në këtë mënyrë nga ky proces po përjashtohet opozita

duhet të jetë përfaqësuesi i deritanishëm i vendbanimit përkatës. "Komisionin e formon Kuvendi në mbledhjen e ardhshme duke e respektuar këtë procedurë" tha ai. Ky sqarim i kryesuesit Gërbiq nuk

e ka kënaqur këshilltarin Halimi, i cili ka kërkuar që në përbërjen e anëtarëve të komisionit të jenë edhe përfaqësues të opozitës. "Mënyra e tillë e përzgjedhjes së anëtarëve të komisionit për zgjedhjet e

kryetarëve të fshatrave opozitën. Duke pasqyruar përfaqësuesit e fshatrave rëndësi të madhe në proces nuk duhet të jetë transpa-

ADMINISTRATA E KOMUNËS SË LIPJANIT KRITIKOHET PËR MOSTRANSPARENÇË

Shoqëria civile akuzon shërbimin e Kuvendit për mosdërgim materialesh



Arian Duriqi

LIPJAN, 28 JANAR - Organizata joqeveritare YAHR në Lipjan ka reaguar ashpër ndaj Administratës së Kuvendit për mosdërgimin e materialeve të seancës së 35-të të Kuvendit Komunal të Lipjanit, që do të mbahet të mërkurën, më 30 janar.

"Organizata jonë më 16 shkurt 2011 i ka bërë kërkesë Administratës Komunale të legjislativit për dërgimin e materialeve në formë elektronike dhe kjo kërkesë është miratuar nga Administrata. Që nga atëherë rregullisht kemi pranuar materialet e seancave të KK-së, por kësaj radhe nuk kemi pranuar asnjë material, edhe pse materialet për seancë i kanë marrë të gjithë kuvendarët", ka thënë Bekim Krasniqi, udhëheqës në YAHR.

Për më tepër, ai këtë fakt e ka parë edhe si lloj bojkoti ndaj OJQ-së që drejton, pasi që pretendon se legjislativi lipjanas po bën përpjekje të hermetizohet.

"Ky është thjesht një bojkot, apo frikë e Administratës së Kuvendit Komunal ndaj organizatës sonë, pasi që në këtë seancë do të diskutohet për disa vendime të rëndësishme të cilat do të ndikojnë drejtpërsëdrejti tek interesi dhe

mirëqenia e qytetarëve të Komunës së Lipjanit dhe kështu që ndoshta kanë dashur që të jenë të mbyllur ndaj shoqërisë civile", ka vlerësuar ai.

Dhe, ky veprim siç ka thënë ai, nga ana tjetër është në kundërshtim edhe me ligjin për qasje në dokumentet publike Nr. 03/L-215 të datës 07.10.2010 të Republikës së Kosovës. Është në kundërshtim edhe me Rregulloren komunale për transparencë. Ndërkohë që Luzim Rustemi, kryesues në KK të Lipjanit, ka deklaruar se mosdërgimi me kohë i materialit të anëtarët jashtë KK-së mund të jetë një gabim procedural dhe asgjë tjetër. Ai ka ripërsëritur se KK-ja është e hapur për të gjithë dhe se, sipas tij, s'ka asnjë tendencë për të bllokuar pjesëmarrjen e dikujt në mbledhje dhe ka shtuar po ashtu se lëshime të tilla nuk do të ndodhin në të ardhshëm. "Kuvendi i Lipjanit ofron transparencë të plotë në harmoni me ligjin dhe nuk bën asnjëherë përpjekje për hermetizim. Në rastin konkret ka mundur të ndodh një lëshim në dërgim materiale, por kjo nuk do të thotë se jemi në përpjekje për të mbyllur seancat e KK-së për publikun, sepse kjo nuk ndodh", ka thënë ai.

Ukë Selimaj

PEJË, 28 JANAR - Zona përreth Mullirit të Haxhi Zekës, që lidhet me shkollën fillore "Ramiz Sadiku", dhe me qendrën zejtare, ka mbetur në fazën ideore të përgjegjësve komunalë për implementim projektsh. Banorët e lagjes dhe nxënësit e dy shkollave që kalojnë nëpër këto rrugë e kanë të vështirë të ecin nëpër rrugë të mbushura me baltë, ndërkohë që komuna vazhdon premtimin. Ahmet Mahmutaj, drejtor i Urbanizmit ka thënë se ekziston një plan se si të zgjidhet ky problem, por, sipas tij, janë të domosdoshme takimet publike me qytetarë, si dhe zgjidhja e çështjes së shpronësimit të disa pjesëve përreth. "Kjo do të diskutohet në debate publike që do të organizohen, si dhe do të diskutohet edhe në mbledhjen e ardhshme të asamblesë", ka thënë Mahmutaj. Ai ka shtuar se qëllimi i këtij projekti është të zgjerohet hapësira e gjelbër, por së pari duhet të bëhet eksproprijimi (shpronësimi). Kjo pritet që shpejt do të rregullohet, ka thënë Mahmutaj. Rrënimin e disa ndërtimeve të vjetra dhe heqja e deponive që sa vite e kanë mbuluar atë hapësirë, pritet të zëvendësohet me hapësirë të gjelbëruar. "Pjesa rreth mullirit pritet të krijojë një alternativë tjetër, të bëhet zonë e gjelbëruar", ka thënë Mahmutaj.

Por implementimi i këtyre projekteve të mbetura pezull duket se kanë hasur në probleme me pronarët e lokaleve përreth, shkaku i shpronësimit të pronave të tyre edhe se Mahmutaj e konsideron si problem të kapërcyeshëm. "Ata e dinë se lokalet i kanë të përkohshme, por atyre do t'u jepet mundësia për t'i parashtruar kërkesat e tyre në debate publike", ka thënë Mahmutaj. Por ndryshe mendon Naim Sahiti, drejtor i Punë Komunale dhe i Shërbimeve Publike,

Ngec për të lagjes "H"



Ahmet Mahmutaj, i cili si të zgjidhet ky problem publike me qytetarët pjesëve përreth

pasi në këtë zonë ndara projektet. Një hapësirave përreth limi i rrugës që për lagjen. Sahiti ka thënë se çështjet pronësore pengon vazhdimin e zonës dhe rrugës. "do të kryhen punë të mëdha pronësore", derisa ka shtuar ekziston edhe për të thënë se drejtoria e rregulluar kanalin rreth Mullirit, e tar edhe rrugën.